



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/103

Datë: 14.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhjet; 101 dhe 102 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/103
Datë: 14.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Qeveritar i Republikës së Kosovës për kompletimin e dosjes për UNESCO që Eposi i Kreshnikëve të vlerësohet dhe të radhitet ndër kryeveprat e trashëgimisë gojore të njerëzimit.
2. Komisioni do të jetë në përbërje të:
 - a. Prof. Dr. Zymer Neziri
 - b. Prof. Dr. Shaban Sinani
 - c. Prof. Dr. Vasil Tole.
3. Komisioni harton dhe miraton rregulloren e punës si dhe mund të ftojë, për bashkëpunim për kryerjen e misionit të vet, këshilltarë shkencorë, recensentë, oponentë, relatorë vendës e të huaj.
4. Koordinator i referimit në kuadër të kësaj nisme caktohet z. Valton Beqiri, ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili mban lidhjet zyrtare ndërmjet Komisionit, Institutit Albanologjik të Prishtinës, Qeverisë së Kosovës dhe UNESCO-s.
5. Mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve të Komisionit sigurohen nga Buxheti i Qeverisë së Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Instituti Albanologjik i Prishtinës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/103
Datë: 14.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projekt-kodi i drejtësisë për të Miturit.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projekt-kodin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë